



Njoftim për shtyp 17 Shtator 2020

17 September, 2020 by **KLGJ** in **NJOFTIME PËR SHTYP**

Sot me datë 17.09.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor zhvilloi mbledhjen plenare të radhës në të cilën shqyrtoi disa çështje të rëndësishme. Më konkretisht:

Me qëllim hapjen rrugë procedurave të lëvizjes paralele të magjistratëve, pas një punë të rëndësishme në bashkëpunim me misionet e asistencës si dhe pas konsultimit me trupën gjyqësore, Këshilli miratoi aktin nënligjor, atë mbi kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të magjistratëve.

Në kuadër të menaxhimit të fondeve buxhetore, Këshilli miratoi vendimin për rishpërndarjen e fondeve për shpenzime personeli, mbi dhënien e shtesës për vështirësi në punë për gjyqtarët e gjykatave të posaçme.

Pas shqyrtimit të kërkesave të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Këshilli vendosi rihapjen e procedurës së komandimit në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve si dhe zgjatjen e afatit të komandimit të përkohshëm si inspektor të magjistrates znj. Marsela Pepi.

Gjithashtu, Këshilli miratoi vendimet për verifikimin e plotësimit të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit, për gjyqtarët znj. Etleva Temo, znj. Iliriana Olldashi, z. Sandër Simoni, z. Sokol Binaj, znj. Arbena Ahmeti, znj. Elona Toro, znj. Klodiana Gjyzari, znj. Mariana Shegani, **znj. Nertina Kosova** dhe z. Artur Kalaja.

Në përfundim, Këshilli vendosi caktimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së ILD-së për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor {...}.

Informacioni i mësipërm është marrë në faqen zyrtare të KLGJ-së në rubrikën e njoftimeve në linkun:

<https://klgj.al/2020/09/njoftim-per-shtyp-17-shtator-2020/>